

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ARLA CLEANING SERVICES" Sh.p.k.

Ne kete Statut:

- "Ligji" eshte ligji nr. 9901, me date 14.04.2008 "PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE"
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise

KREU I

THEMELIMI, EMERTIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA DHE SELIA

Neni 1 - Data e themelimit, Emertimi dhe Themeluesit e Shoqerise

1.1. Sot me 21 Mars 2018 ortaket themelues, kane themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin " **ARLA CLEANING SERVICES** "Sh.p.k

1.2. Themeluesit e shoqerise jane:

- a) **Vellis KONSTANTINOS**, me kombesi greke, lindur ne OULM (Gjermani) me 06/09/1966 dhe banues ne Tenarou,No.4,Katerini, Greqi. Me pasaporte me Nr.AN 3584492.
- b) **Eleana BASHO**, me kombesi shqiptare, lindur ne Gjirokaster (Shqiperi) me 10/09/1987 dhe banues ne Kompleksi Ciklades,Sauk,Tirane me karte identiteti I75910084G

Neni 2 - Objekti

2.1. Objekti i shoqerise **ARLA CLEANING SERVICES Sh.P.K.** eshte Pastrim industrial, familjar, kimik, jokimik, tapicerie, lavazhe makinash. Imp-eks tregetim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial ,ushqimor. Hapje pika servisi, lavazhoje. Transport mallrash. Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, bar-restoranti, diskoteka, qendra pushimi kurative. Sherbime ne fushen e sistemeve te aluminit. Sherbime mirembajtje, sherbime kopshtarie. Sherbim Catering. Sherbim postar. Administrim Pallatesh.

2.2. Ne lidhje me objektin e shoqerise, kjo e fundit mund te kryej te gjitha operacionet tregtare, financiare qe nuk jane te ndaluara me ligj, mbi pasurite e luajtshme dhe e te paluajtshme te nevojshme ose te dobishme per arritjen e objektit te shoqerise.

2.3. Shoqeria mund te kryej edhe fdo lloj aktiviteti tjeter ndihmes dhe te nevojshem qe ka lidhje te mjaftueshme me kete objekt aktiviteti dhe qe nuk bie ndesh me ligjet shqiptare ne fuqi.

2.4. Ajo gjithashtu mund te jape mbeshtetje apo garanci personale (fideiussione) e cdo garanci tjeter edhe reale, dhe ne favor te paleve te treta dhe gjithashtu mund te marre pjese, drejtperdrejt ose ne menyre indirekte ne fitimet e nje ndermarrje tjeter (interessenze) dhe te marre gjithashtu pjese ne shoqeri apo ndermarrje te tjera me objekt analog, te afert ose te lidhur me objektin e saj.

Neni 3 - Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte deri ne 30 (tridhjetete) dhjetor 2055 (dymije e pesedhjetete e pese).



Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia e shoqerise eshte ne **Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga "DON BOSKO", Nr.112, Tirane.**
- 4.2. Adresa elektronike e shoqerise per qellime komunikimi eshte: _____.
- 4.3. Shoqeria mund te stabilizoj, me vendim te Asamblese se Pergjithshme, deget apo zyrat e perfaqesimit brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

KREU II

KAPITALI SHOQEROR

Neni 5 –Kapitali Themeltar

- 5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte ALL 100.000 (njqindmije) dhe eshte i ndare ne 2 (dy) kuota.
- 5.2. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte, ne baze te kontributeve te bera, e ndare si me poshte:
- **Vellis KONSTANTINOS** , zoteron 1 (nje) kuote, me vlere ALL 90,000 qe perben 90% te kapitalit baze te shoqerise;
 - **Eleana BASHO**, zoteron 1 (nje) kuote, me vlere ALL 10,000 qe perben 10% te kapitalit baze te shoqerise;

Neni 6 - Rritja dhe reduktimi i Kapitalit

- 6.1. Rritjet e kapitalit te nenshkruara nga ortaket do te paguhen permes kontributeve ne para.
- 6.2. Shumica nuk mund te detyroje, ne asnje rast, nje ortak te rrise kuoten e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- 6.3. Zvogelimi/reduktimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Pergjithshme e cila do te marre vendimin me shumicen e parashikuar per ndryshimin e Statutit.
- 6.4. Ne çdo rast zvogelimi i kapitalit prek ortaket ne te njejten perqindje me te cilen ata marrin pjese ne kapitalin shoqeror.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

- 7.1. Kuotat dhe te drejtat e dhena nga ana e tyre, mund te blihen ose te transferohen nepermjet:
- Pjesemarrjes ne rritjen e kapitalit;
 - Blerjes;
 - Trashegimise dhe Donacionit;
 - Menyra te tjera te parashikuara ne ligj.
- 7.2. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
- 7.3. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.
- 7.4. Ne rast te transferimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te jete me shkrim.
- 7.5. Transferimi i kuotave te kapitalit paleve te treta do te lejohet vetem pas nje opinionimi/mendimi te favorshem i te gjithe ortakeve te tjere.
- 7.6. Ortaku i cili deshiron te shese, edhe pjeserisht, pjesen e tij, duhet te njoftoje me shkrim vullnetin e tij oratkeve te tjere, duke treguar çmimin me metoden e pageses dhe identitetin e blesesit. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes.



7.7. Nëse ortakët që duan ta blejnë janë me shumë se një, pjesëmarrja e ortakut transferues duhet të ndahet midis të gjithëve në proporcion me investimet e bera nga ortakët.

7.8. Nëse asnjë ortak nuk ushtron të drejtën e parablerjes, hyrja e ortakut të ri është i varur nga miratimi i ortakëve të tjerë.

7.9. Personi që transferon kuotën dhe ai që e blen përgjigjen bashkërisht dhe individualisht për detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i kuotës, që nga momenti i transferimit të kuotës deri në momentin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 10 të këtij neni.

7.10. Shoqëria regjistron transferimin e kuotave, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, të 05/03/2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit".

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË DHE PROCESËT VENDIMARRËSE

Neni 8 - Asambleja e Përgjithshme

8.1. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është i vetmi organ vendimarrës i shoqërisë.

8.2. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi që miraton modifikimet e Statutit sipas menyrave të përcaktuara me ligj.

8.3. Asambleja e Përgjithshme ka kompetenca mbi çështjet në vijim:

a) Ngritja e politikave të biznesit;

b) Modifikimi i statutit;

c) Emerimin dhe revokimin e administratoreve;

ç) Emerimin dhe shkarkimin e revizoreve dhe të likuiduesve të pavarur;

d) Kompensimi i personave në pikat "c" dhe "ç";

dh) Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të politikave të biznesit nga ana e administratoreve, duke përfshirë përgatitjen e llogarive vjetore dhe raportin e veprimtarive;

e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të veprimtarive;

ë) Ndarja e fitimeve vjetore;

f) Rritja dhe ulja e kapitalit themeltar;

g) Përfaqësimi i shoqërisë në procedurat gjyqësore kundër administratoreve;

i) Ristrukturimi dhe prishja e shoqërisë;

j) Miratimin e rregullores së brendshme;

k) çështje të tjera të rezervuara Asamblesë nga ligji ose nga statuti.

8.4. Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme edhe nga një jo-ortak.

8.5. Letra e autorizimit është e leshuar për një mbledhje të vetme të Asamblesë së Përgjithshme dhe është e vlefshme edhe për mbledhjen e ardhshme.

8.6. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i një ortaku në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 9 – Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

9.1. Asambleja mbledhet/thirret me leter apo nëpërmjet postës elektronike.



9.2. Letra apo e-mail duhet te permbajne vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe ti dorezohet se bashku me rendin e dites te gjithe anetareve brenda dhe jo me vone se 7 dite para dates se caktuar per mbledhjen.

9.3. Ne rast parregullsie ne thirrjen, Asambleja mund marre vendime, vetem nese te gjithe anetaret dhe te gjithe administratoret jane te pranishem dhe vendosin per te vepruar, pavaresisht parregullsise se mbledhjes/thirrjes.

Neni 10 - Kuorumi i themelimit per vlefshmerine e Asamblese

10.1. Ne rastin kur çeshtjet kerkojne shumicen e zakonshme, Asambleja e Pergjithshme perbehet ne menyre te vlefshme me pranine e ortakeve qe mbajne me shume se 50% te kuotave te nenshkruara.

10.2. Në rastin kur çeshtjet kerkojne nje shumice te kualifikuar, Asambleja e Pergjithshme perbehet ne menyre te vlefshme me pranine e ortakeve qe zoterojn me shume se 80% te kuotave te nenshkruara.

10.3. Asambleja - nese Kryetari konstaton nevojen apo mundesine - mund te mbahet ne menyre te vlefshme me ane te mjeteve te telekomunikacionit (audio/video-konference), per aq kohe sa i lejohet Presidentit te konstatoje identitetin e personave qe kane te drejte per te nderhyre, rregulluar zhvillimin e takimit, te konstatoje dhe shpall rezultatet e votimit dhe tu jete e garantuar pjesemarresve mundesia per te nderhyre ne menyre aktive dhe duke folur, ne kohe reale, per te gjithe argumentet e rendit te dites.

10.4. Nese Asambleja nuk mund te mbahet per shkak te mungeses se kuoromit te paragrafeve 1 dhe 2, mbledhja do te thirret perseri me te njejtin rend dite te propozuar brenda 30 ditesh.

Neni 11 - Marrja e vendimeve. Kuorumi

11.1. Asambleja e Pergjithshme vendos me voten ne favor te 80 % te kapitalit shoqeror mbi modifikimin e Statutit, mbi shperndarjen e fitimeve, mbi rritjen dhe uljen e kapitalit themeltar dhe mbi ristrukturimin dhe prishjen e shoqerise.


11.2. Asambleja e Pergjithshme vendos me voten ne favor te shumices se thjeshte te te gjithe kapitalit shoqeror per te gjitha çeshtjet e tjera, të tilla si: vendosjen e politikave te biznesit, emerimin dhe revokimin e administratoreve; emerimin dhe revokimin e revizoreve dhe te likuiduesve te pavarur; kompensimin per personat e permendur ne pikat "c" dhe "ç"; monitorimin dhe kontrollin e zbatimit te politikave te biznesit nga ana e administratoreve, duke perfshire pergatitjen e llogarive vjetore dhe raportin e veprimtarise; miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te veprimtarive; perfaqesimin e shoqerise ne procedurat gjyqesore kunder administratoreve; miratimin e rregullores se brendshme; krijimin e degeve apo zyrave te perfaqesimit brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

11.3. Çdo modifikim i Statutit duhet te dorezohet ne QKR me qellim qe te reflektohen ndryshimet ne dosjet/file e shoqerise.

Neni 12 - Perjashtimi nga e drejta per te votuar

12.1. Nje ortak nuk mund te votoje ne qofte se Asambleja e Pergjithshme vendos:

a) mbi vleresimin e sjelljes se tij;



- b) mbi mospermbushjen e detyrimeve te tij si ortak;
- c) mbi çdo ankese te paraqitur kunder tij nga shoqeria;
- ç) mbi lejimin e çfaredolloj perfitimi ne favor te tij.

12.2. Neqoftese nje partner eshte i perfaqesuar nga nje zevendesues ne Asamble, perfaqesuesi konsiderohet te jete ne te njejtin pozicion te te perfaqesuarit per sa i perket konflikteve te interesave.

Neni 13 - Procesverbali i mbledhjes se Asamblese

13.1. Te gjitha vendimet e Asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne nje procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme.

13.2. Procesverbali duhet te permbaje daten dhe vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit te mbajtjes se regjistrave, rezultatet e votimeve.

13.3. Procesverbalit i bashkengjitet lista e pjesemarresve, si dhe njoftimi/thirrja e Asamblese se Pergjithshme.

13.4. Procesverbali i mbledhjes do te nenshkruset nga kryetari/presidenti dhe nga personi qe eshte i ngarkuar per konservimin e tij.

13.5. Nese shoqeria ka nje faqe interneti, administratoret, jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes, jane te detyruar te publikojne ne kete faqe kopje te procesverbalit te mbledhjes se Asamblese se pergjithshme.

Neni 14 - Administrimi

14.1. Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizik si Administratore te shoqerise per nje periudhe prej 3 (tre) vjet me mundesi rizgjedhjeje. Emerimi ka efekte juridik pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

14.2. Shoqeria do te kete 2(dy) Administratore te cilet jane:

- a) **-Z.Vellis KONSTANTINOS, Administrator**
- b) **Znj.Elena BASHO, Administratore,**

Kohezgjatja e tyre do te jete 3 vjet nga dita e regjistrimit ne QKR.


Neni 15 – Te drejtat dhe detyrimet e Administratoreve

15.1. Administratoret veprojne, duke marre parasysh interesat e shoqerise dhe te ortakeve.

15.2. Pervec rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj ose nga statuti, Administratoret ne kushte te barabarta trajtojne ne menyre te barabarte dhe pa dallim ortaket e shoqerise.

15.3. Administratoret kane te drejten dhe detyrimin te:

- a) Menaxhojne bizneset e shoqerise nepermjet zbatimit te politikave te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) Perfaqesojne shoqerine;
- c) Te sigurojne se librat dhe dokumentet te ruhen sic duhet;
- ç) Pergatisin dhe nenshkruajne pasqyrimin e llogarive vjetore, te llogarive te konsoliduara dhe raportin mbi veprimtarine dhe ti paraqesin ato ne Asamblene e Pergjithshme per aprovim se bashku me propozimet per ndarjen e fitimeve;



d) Krijimin i nje sistemi paralajmerimi te shpejte ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;

dh) Trajtojne regjistrimin i shoqerise dhe çdo ndryshim te mevonshem duke paraqitur te dhenat e nevojshme te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) Tu raportojne Asamblese se Pergjithshme per sa i perket zbatimit te politikave tregtare (business) dhe realizimit te veprimeve me rendesi te veçante;

e) Te kryejne detyra te tjera qe parashikohen me ligj dhe ne statut.

15.4. Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

a) Sipas bilancit vjetor ose regjistrimeve te ndermjetme te rezultoje apo ekzistojne rreziku qe pasuria e shoqerise mund te mos mbuloje detyrimet e saj te parashikuara ne tre muajt ne vijim;

b) Kompania propozon te shese apo te disponoje ndryshe te mirat e pasurise se saj per shumat mbi 5% te pasurise totale te shoqerise, siç rezulton nga bilancet e fundit te certifikuara;

c) Kompania, brenda dy viteve te para pas regjistrimit, propozon per te blere te mira qe i perkasin njeortaku dhe qe shuma arrin deri 5% te pasurise te shoqerise, siç rezulton nga bilancet e fundit te certifikuar.

15.5. Ne rastet e pikave 4.a), 4.b) dhe 4.c), te nenit ne fjale, Asamblese se Pergjithshme i prezantohet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.

15.6. Dispozitat e pikave 5) te nenit ne fjale nuk aplikohen nese blerjet, sipas pikave 4.b) e 4.c) te po ketij neni, kryhen ne burse ose bejne pjese ne veprimet e perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.

15.7. Ne rastet e parashikuara te pikave 4) dhe 6) te ketij neni, Asambleja e Pergjithshme mund te aprovoj nje shqyrtim konsultativ duke aprovuar ose duke bere vezhgime/verejtje mbi aktivitetin e administratoreve.

15.8. Administratoret, kane çdo fuqi mbi ushtrimin e veprimtarise se shoqerise dhe, pa autorizim te nevojshem nga Asambleja, mund:

a) te permbyllin kontrata aktive dhe pasive furnizimi, punesimi dhe sherbime.

b) te permbyllin kontrata me qira dhe nenqira per ndertesa/pasuri te paluajtshme qe kane per qellim ushtrimin e aktivitetit shoqeror;

c) te punesojne personelin, duke caktuar dhe shperblimin;

ç) te shkarkojne nga puna personelin;

d) te permbyllin kontrata bankare dhe siguracioni, te hapin dhe mbyllin llogari bankare (rrjedhese);

dh) te emerjojne eksperte kontabel dhe eksperte mbi punesimin per asistencen e shoqerise;

e) te emerjojne avokate dhe eksperte kontabel per mbrojtjen e shoqerise ne çdo Gjykate dhe Jurisdiksion.

15.9. Nese Asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata menaxhojne sipermarrjen bashkarisht, me kompetenca te perbashketa dhe te veçanta.

15.10. Administratoret mund te emerojne/ te ngarkojne dike per te kryer detyra te veçanta, duke deleguar disa nga kompetencat e tij.

15.11. Asambleja e Pergjithshme mund te revokoj Administratorin ne çdo moment me nje shumice te zakonshme. Çdo ankese, duke perfshire dhe ato qe lidhen me shperblimin e Administratorit, qe rrjedhin nga cdo raport kontraktual mes shoqerise dhe Administratoreve jane te dishiplinuar nga ligjet ne fuqi.



Neni 16 - Përgjegjësi e administratorit

16.1. Administratori ka përgjegjësi ndaj shoqërisë ose paleve të treta për demet e shkaktuara nga shkelja e ligjeve, statutit ose nga gabimet e bera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.2. Pasojat për çdo marrëveshje të pa miratuar nga Asambleja, e cila i sjell dem shoqërisë, do të ngarkohen Administratorit dhe, kur është e pershtatshme, së bashku, me ortakun i cili e ka autorizuar.

16.3. Përveç asaj cka është e parashikuar në dispozitat e përgjithshme mbi mandatin e mirebesimit, në përputhje me nenet 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori është i detyruar që:

- a) të kryej detyrat e parashikuara me ligj dhe nga Statutet mirebesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke përfshirë edhe mbështetjen mjedisore të aktiviteteve të tyre;
- b) të ushtroj kompetencat e dhëna me ligj dhe nga Statuti vetëm për qëllimet e specifikuar në të;
- c) marrë në konsideratë në mënyrë pershtatshme çështjet që duhet të merren në vendim;
- ç) të evitohet konfliktet aktuale apo potenciale midis interesave personale dhe interesave të shoqërisë;
- d) të kryej detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdes.

16.4. Administratori në kryerjen e detyrave të tij, është përgjegjës për çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me qëllimet e shoqërisë tregtare, përveç nëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirebesim dhe është konsideruar në përputhje me qëllimet e shoqërisë në bazë të njohurive dhe informacioneve në mënyrë të arsyeshme.

16.5. Në rast se Administratori vepron në kundërshtim me detyrat e tij, ai është i detyruar të shpërblejë shoqërinë për demet e shkaktuara nga shkelja dhe të kthejë çdo fitim personal të tij ose të personave lidhur me të, që është rezultat i shkeljes së detyrave ndaj shoqërisë. Administratori ka barrën për të treguar përputhshmerinë e sjelljes me detyrimet e tij dhe me rregullat. Në rast se shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë.

16.6. Vecanerisht, me liste ilustruese por jo gjithëpërfshirëse, Administratorit i kërkohet/është i detyruar të kompensojë shoqërinë për demin e shkaktuar, në qoftë se në kundërshtim me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen veprimet e mëposhtme në shkelje të këtij ligji:

- a) i kthen ortakëve kontributet;
- b) paguan interesa apo dividende ortakëve jashtë rasteve të lejuara nga ligji dhe Statuti;
- c) shpërndan pasurinë e shoqërisë;
- ç) lejon shoqërisë të vazhdojë të bëjë biznese kur sipas gjendjes financiare duhet të kishte parashikuar se nuk do të jete në gjendje të paguaj borxhet e saj;
- d) jep hua ortakëve o të treta pa autorizim nga Asambleja.

16.7. Përveç kërkesës për kompensim për demin e shkaktuar nga administratori personalisht, ortakët individualisht ose bashkërisht, kanë të drejtë të bëjnë një denoncim penal kundër administratorit.

16.8. Kandidatet kanë të drejtë të ngrejne padi për kompensim të plotë të demit të shkaktuar ndaj shoqërisë.

16.9. Asambleja e Përgjithshme nuk mund të ndalojë paraqitjen e një ankese kundër Administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyres.



KREU IV
MARREDHENIA MIDIS SHOQERISE DHE ORTAKEVE

Neni 17 - Ndarja e fitimeve

- 17.1. Ortaket kane te drejte te ndajne fitimin e treguar ne bilancin e shoqerise.
17.2. Fitimi shperndahet midis ortakeve ne perpjesetim me kuotat e tyre.

Neni 18 - Kushtet per ndarjen e fitimeve. Certifikata e aftesise paguese

- 18.1. Shoqeria mund te ndaj fitimet midis ortakeve vetem nese, pas pagimit te fitimeve:
a) aktivitetet e shoqerise mbulojne ende plotesisht pasivitetet e saj;
b) shoqeria ka ende aktive likuide te mjaftueshme per te rimborsuar detyrimet qe mund te kerkohen brenda 12 mujave.
18.2. Administratori leshon nje certifikate te aftesise paguese, e cila ne menyre te qarte verteton se shperndarja e propozuar nga dividendet permbush kerkesat e pikes 1 te ketij neni.
18.3. Kur statusi/gjendja i/eshoqerise tregon se shperndarja e propozuar e fitimeve nuk i ploteson kerkesat e pikes 1 te ketij neni, Administratori nuk mund te leshoj certifikaten.
18.4. Administratori pergjigjet per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU V
USHTRIMI FINANCIAR – EKSPERTET

Neni 19 - Viti Financiar

- 19.1. Viti financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor per çdo vit kalendarik. Me perjashtim te vitit te pare, i cili fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Neni 20 –Eksperte kontabel

- 20.1. Eksperti kontabel, ne rast se emerohet ka detyrimin per te kontrolluar te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare.
20.2. Kontrolli do te jete vjetor por edhe periodik.
20.3. Ne perfundim te kontrollit, eksperti kontabel pergatit raportin, me shkrim, mbi rezultatet e bilancit vjetor, si dhe raportin per kontrollimet periodike, qe eshte i detyruar te paraqese dhe dergoje ne kohe ortakeve per vendimet dhe miratimin ne ushtrimin e te drejtes se tyre per te votuar.

KREU VI
PRISHJA, SHKRIRJA DHE RISTRUKTURIMI I SHOQERISE

Neni 21 - Prishja dhe Likuidimi

- 21.1. Shoqeria mund te priset ne çdo moment, ne rastet e meposhtme:
a) skadimit te periudhes per te cilen eshte themeluar;
b) vendimit te Asamblese se pergjithshme;



c) hapja e procedurave te falimentimit;

d) eshte jo-aktive per dy vjet pa njoftuar gjendjen ne perputhje me paragrafin 3 te Art. 43 i Ligjit Nr 9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

dh) vendim te gjykates.

21.2. Shkrirja e shoqerise tregtare ka si pasoje fillimin e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, pervec rastit kur ka filluar procedura e falimentimit.

21.3. Ortaket te cilet vendosin prishjen:

a) vendosin me shkrim

b) parashikojne menytrat e likuidimit te shoqerise

c) emerojne nje ose me shume likuidatore.

21.4. Te gjitha dokumentet e leshuara nga shoqeria duhet te tregojne emrat e likuiduesve dhe te mbajne shkrimin shtese "Shoqeri ne likuidim".

21.5. Likuidimi do te ushtrohet nga likuiduesit ne emer te ortakeve.

21.6. Kur ortaket nuk marrin nje vendim mbi emerimin e likuiduesve, 30 dite pas shkrirjes se shoqerise, cdo person i interesuar mund te beje kerkese ne gjykate per te emeruar nje likuidues.

Neni 22 - Ristrukturimi i shoqerise - Bashkimi/Shkrirja - Ndarja

22.1. Shoqeria mund te ndahet apo te bashkohet ne nje shoqeri tjeter ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit n. 9901, datel4/04/2012/ "Mbi tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Neni 23 - Baza ligjore

23.1. Shoqeria duhet zhvilloje aktivitetin e saj ne pajtim me kete Statut dhe me dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar.

23.2. Pervec rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit "Mbi tregtaret dhe shoqerite tregtare", te Kodit Civil dhe te cdo ligji tjeter specifik i Republikes se Shqiperise.

Neni 24 - Mosmarveshjet


24.1. Te gjitha mosmarveshjet qe kane per objekt raportet shoqerore, duke perfshire dhe ato qe lidhen me vlefshmerine e vendimeve te asamblese, te lejuara nga ortaket ose kunder ortakeve, nga shoqeria apo kunder shoqerise, nga administratoret apo kunder administratorëve, nga ekspertet kontabel apo kunder eksperteve kontabel, nga likuiduesit apo kunder likuiduesve, do tu nenshtrohen Gjykatave Shqiptare.

Ortaket themelues te " **ARLA CLEANING SERVICES** " Sh.p.k.

(Nenshkrimi/firma)

Vellis KONSTANTINOS

Eleana BASHO



The image shows two handwritten signatures on a light-colored background. The top signature is in dark ink and reads "Vellis Konstantinos" followed by a stylized signature. The bottom signature is in a lighter ink and reads "Eleana Basho" followed by a stylized signature.